



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Të Folurit Publik

Ngarkesa: 3 ects; 15 leksione, 15 seminare

Viti / Semestri : Viti I , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: *Master Shkencor “Përkthim teknik letrar dhe interpretim”*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNI:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të zhvillojë aftësitë e studentëve për të ligjëruar në publik në mënyrë etike, të qartë dhe efektive. Të ndërtojë vetëbesimin dhe kompetencën e studentëve për të përballuar situata të ndryshme të të folurit publik. Të formojë bazat teorike dhe praktike për strukturimin, organizimin dhe prezantimin e fjalimeve përpara audiencës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të pajisë studentët me njohuri mbi etikën e të folurit në publik dhe mbi rolin qytetar të ligjëruesit.
2. Të aftësojë studentët për të planifikuar, përgatitur dhe mbajtur fjalime informuese, bindëse dhe të rastit.
3. Të zhvillojë aftësinë për kërkim tematik, analizë të audiencës dhe përpunim të mesazhit të përshtatur.
4. Të mundësojë përdorimin efektiv të mjeteve vizuale dhe teknologjisë në mbështetje të fjalimeve.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Hartojnë dhe mbajnë fjalime të strukturuar dhe të përshtatshme për kontekste të ndryshme komunikimi publik.
2. Zbatojnë parimet etike gjatë përgatitjes dhe mbajtjes së një fjalimi.
3. Kryejnë kërkime, analizojnë audiencën dhe përshtatin përmbajtjen e fjalimit për qëllime të ndryshme komunikimi.
4. Përdorin mjete pamore në mënyrë funksionale për të forcuar mesazhin e fjalimit.